



# Buletin Informativ

SHTATOR 2014 - JANAR 2015



## REFORMA ADMINISTRATIVO TERRITORIALE KONSOLIDIMI ADMINISTRATIV DHE FINANCIAR I 61 BASHKIVE TË REJA

HYRJE  
NGA  
MINISTRI  
[FAQE 2](#)

REFORMA  
EVITIT  
[FAQE 3](#)

FORCOHET  
MBËSHTETJA  
NDËRKOMBËTARE  
[FAQE 5](#)

PROGRAMI  
PILOT  
[FAQE 6](#)

GRUPET  
MBËSHTETËSE  
[FAQE 7](#)

TAKIME  
INFORMUESE  
[FAQE 8](#)



Të nderuar lexues,

Një vit më parë u angazhuam në hartimin dhe realizimin e një prej reformave më të rëndësishme strukturore mbi institucionet publike në Shqipëri, reformën administrativo-territoriale. Më 31 korrik 2014 u hodh një hap historik drejt realizimit të saj, Kuvendi miratoi ligjin “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Me miratimin e këtij ligji, i jepet fund copëzimit të territorit duke e organizuar qeverisjen vendore në vetëm 61 bashki. Sipas ndarjes së re këto njësi do të mund të ofrojnë më shumë shërbime publike dhe më moderne për qytetarët në çdo skaj të vendit. Organizimi i ri territorial synon rritjen e investimeve publike për rivitalizimin e qyteteve dhe fshatrave si dhe mundësi më të mëdha për një zhvillim ekonomik të qendrueshëm.

Për të gjitha arritjet tona gjatë vitit të reformës administrativo-territoriale, dua të shpreh mirënjojen time dhe të qeverisë shqiptare ndaj partnerëve ndërkombëtarë të projektit “STAR”; qeverinë amerikane, sundeze, zvicerane, italiane, si dhe organizata e PNUD-it, OSBE-së dhe Këshillit të Europës.

Jam krenar që së bashku arri të realizonim një proces, i cili përbën një model për hartimin dhe miratimin e legjilacioneve të kësaj përmase në Shqipëri. Kjo reformë në fazën e hartimit të saj, përbashi standardë më të larta të gjithëpërfshirjes dhe transparencës.

Realizimi i hartës së re është vetëm fillimi i një pune shumë të madhe që do të na çojë drejt konsolidimit të bashkive të rëja, për ta kthyer qeverisjen vendore në një instrument demokratik që do t'i shërbejë qëllimit final: ofrimit të shërbimeve më cilësore dhe eficiente komuniteteve.

Përmes këtij buletini informativ dëshirojmë t'ju pasqyrojmë arritjet e përbashkëta, sfidat që kemi kapërcyer dhe t'ju informojmë për ngjarjet dhe zhvillimet më të fundit. Ky buletin do t'ju shoqerojë në vijim përgjatë fazës së zbatimit të reformës territoriale duke ju raportuar rreth aktivitetave të projektit “STAR” dhe reformës në tërësi.

Bledi Çuçi  
Ministër Shteti për Çështjet Vendore



Miratimi i ligjit 115/2014 "Për ndarjen e re administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

## Reforma e vitit

**P**ër herë të parë pas më shumë se dy dekadalash, qeveria shqiptare po realizon reformën administrativo-territoriale, një prioritet strategjik i qeverisë shqiptare.

Kuvendi i Shqipërisë miratoi më 31 korrik 2014 ligjin 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" dhe hartën me 61 bashki, certifikuar në dhjetor 2014 edhe nga Gjykata Kushtetuese.

Për të arritur tek ndarja e re, përgjatë vitit 2014 u zhvillua një proces kompleks ku u angazhuan të gjithë aktorët e interesit, u kryen analiza të detajuara dhe studime të situatës së qeverisjes vendore në Shqipëri nga një grup ekspertësh vendas dhe të huaj.

Duke u bazuar për herë të parë në metodologjinë moderne të "zonave funksionale", u hartuan kriteret teknike të cilat ishin baza kryesore e përgatitjes së hartës së re administrativo-territoriale. Këto kritere të miratuara nga Komisioni i Posacëm Parlamentar i reformës, ju nënshtruan një procesi të gjerë konsultimi publik me përfaqësues të qeverisjes vendore, shoqatat e të zgjedhurve vendorë dhe grupet e interesit në të gjitha qarqet.

Me miratimin e variantit të hartës së re me 39 dhe 47 njësi vendore nga Komisioni Parlamentar, nisi një tjetër proces intensiv konsultimi publik mbarëkombëtar. Përmes takimeve të hapura në çdo qytet, qendër qarku, bashki e komunë, peticioneve me shkrim dhe online, konsultimeve me grupe interesi dhe sipërmarrës, u diskutua dhe u kërkua mendimi për variantet e propozuara.

Në total 20,341 qytetarë, përfaqësues të institucioneve publike, shoqërisë civile, organizatave të zhvillimit etj. morën pjesë dhe u angazhuan në çdo hap: konceptimin, diskutimin dhe miratimin e reformës. Procesi u vlerësua si gjithëpërfshirës dhe transparent në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe ligjet në fuqi.

I gjithë procesi u udhëhoq nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, i mandatuar të drejtojë punën për hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e reformës administrativo-territoriale. Partnerë ndërkombëtarë me eksperiençë në çështjet e qeverisjes vendore në Shqipëri, si qeveria suedeze, zvicerane, amerikane ajo italiane dhe UNDP u angazhuan në këtë nismë përmes projektit "STAR" (Support to Territorial and Administrative Reform). "STAR" ka qenë një asistencë e vazhdueshme teknike dhe financiare për procesin dhe strukturat e reformës së bashku me partnerë të tjera ndërkombëtarë si Këshilli i Evropës, OSBE, Ambasada e Hollandës ajo Austrike, etj.



**20,341**  
qytetarë, përfaqësues  
të institucioneve  
publike, shoqërisë civile,  
organizatave të zhvillimit  
etj. morën pjesë në çdo  
hap të reformës





Ambasadori italian, Massimo Gaiani dhe Koordinatorja e Përherësime e OKB-së, Zineb Touimi-Benjelloun gjatë nënshkrimit të marrëveshjes


## ZBATIMI I REFORMËS

Reforma administrativo-territoriale ka parë zhvillime konstruktive në muajt shtator 2014 – janar 2015 ku në fokus ka qenë faza e zbatimit të saj, para dhe pas zgjedhjeve vendore të 21 qershorit, me të gjithë komponentët përbërës. Gjatë kësaj periudhe reformës kyse të qeverisë shqiptare i janë bashkuar aktorë, ekspertë dhe partnerë të rinj të cilët janë fokusuar në përgatitjen e terrenit dhe përcaktimin e instrumenteve të nevojshëm për konsolidimin administrativ dhe financiar të 373 njësive ekzistuese në 61 bashki sipas hartës së re.

# Forcohet mbështetja ndërkombëtare

Qeveria italiane zyrtarizoi kontributin e saj për projektin “STAR” duke financuar 996,264 dollarë për fazën e zbatimit të reformës administrativo-territoriale. Ambasadori italian, Massimo Gaiani dhe Koordinatorja e Përherësime e OKB-së dhe Përfaqësuesja e Përherësime e UNDP-së, Zineb Touimi-Benjelloun, nënshkruan marrëveshjen në praninë e partnerëve të tjera ndërkombëtarë. Gjatë këtij eventi Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Bledi Çuçi, vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të partnerëve ndërkombëtarë për këtë nismë madhore të qeverisë dhe theksoi “synimin që në një kohë sa më të shkurtër të kemi njësi vendore të cilat të fokusohen në misionin e tyre: të ofrojnë shërbime cilësore dhe efikase për komunitetin.”

Partnerët ndërkombëtarë, të cilët kanë përkrahur drejtëpërdrejtë reformën territoriale në çdo hap dhe kanë dhënë ndihmë teknike përmes projektit, zgjeruan kontributin e tyre financiar pas miratimit të ligjit për ndarjen e re administrativo-territoriale. Fondit të përbashkët të donatorëve për këtë projekt i është shtuar kontributi 648,999 dollarë nga Agjencia Suedze për Zhvillim (SIDA) dhe 402,738 dollarë nga qeveria zvicerane. Kjo shumë e çon buxhetin total të reformës administrativo-territoriale në 3,594,838 dollarë.



**3,494,838 USD**  
është fondi i mobilizuar nga donatorët deri në janar 2015 për projektin “STAR”.

# Program pilot për krijimin e modeleve të suksesshme

Në muajin nëntor reforma filloj hapat praktike të zbatimit përmes programit pilot në bashkitë e Urës Vajgurore dhe Pogradecit, nën mbikqyrjen e Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Z. Bledi Çuci. Përzgjedha e këtyre njësive u bazua në natyrën e tyre administrative, për vetë specifikat që ato mbartin dhe për ngashmërinë me pjesën më të konsiderueshme të bashkive të reja që do të krijohen pas zgjedhjeve.

Programi i pilotimit do të mundësojë krijimin e një modeli bashki që të përdoret në mënyrë që shkrirja e njësive ekzistuese në 61 bashki të realizohet me sukses. Pilotimi po asistohet nga KPMG-ja, një nga kompanitë më të mira në botë në fushën e taksave, auditimit dhe këshillimit. E kontraktuar nga projektii “STAR”, kjo kompani do të përpilojë metodologjinë që do të përbëjë bazën për shkrirjen e njësive vendore në bashkitë e reja të ngashme.

Një grup pune i mirë strukturuar, me specialistë të projektit “STAR” dhe kompanisë KPMG, në bashkëpunim me stafin e njësive vendore, po punojnë për inventarizimin e njësive që bashkohen; Posnjë, Kutali dhe Cukalat që do të bashkohen me bashkinë e re Ura Vajgurore dhe komunat Udenisht, Buçimas, Cer-

rave, Dardhas, Trebinjë, Proptisht dhe Velçan që do të shkrihen në bashkinë e re të Pogradecit. Ky hap do t'i paraprijë krijimit të një modeli të konsolidimit financiar, ristrukturimit organizativ dhe krijimit të një platforme të teknologjisë së informacionit e komunikimit.

Metodologjia do të përbajë edhe sugjerime mbi rishikimin e funksioneve administrative, për të eleminuar mbivendosjen e pozicioneve dhe për të fuqizuar departamentet e nevojshme. Si rrjedhojë, bashkitë do të menaxhohen më mirë, duke bërë të mundur çlirim e fondevë për të lejuar investime dhe për të përmirësuar shërbimet për qytetarët.

Vlerësimi kritik i sistemeve ICT që janë përdorur deri më sot dhe rekomandime për adoptimin e sistemeve të reja, është një tjetër objektiv që synohet të përbushet në këtë fazë.

Metodologjia e hartuar në këtë fazë pilotimi synon të orientojë qartë kryetarët e 61 bashkive të reja jo vetëm përgjatë procesit të bashkimit, por edhe më pas, në atë të konsolidimit të një qeverisje vendore moderne, eficiente dhe transparente.



Ekspertë të kompanisë KPMG dhe stafi i njësive vendore gjatë punës në një nga bashkitë pilote, Pogradec




Takim i grupeve të punës  
në një nga bashkitë  
pilote, Ura Vajgurore

## Grupet mbështetëse

Në vijimësi të reformës administrativo-territoriale ka nisur puna për ngritjen e grupeve të punës, në nivel qendror dhe në nivel qarku. Grupi i parë përbëhet nga përfaqësues të ministrive të linjës, ekspertë teknikë të projektit "STAR", si dhe janë të ftuar të bëhen pjesë e grupit edhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe programeve për zhvillim që operojnë në Shqipëri. Në të njëjtën kohë do të veprojnë edhe grupet e punës në 12 qarqe, përbërë nga përfaqësues të qeverisjes vendore, degës së thesarisit në rrethe, të drejtorive rajonale, kryesuar nga prefekti i Qarkut.

Grupet e punës kanë si objektiv kryesor mbështetjen teknike dhe këshillimin e Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, nëpërmjet hartimit të raporteve dhe kryerjes së analizave dhe studimeve gjatë procesit të konsolidimit administrativ dhe financiar të 61 njësive të reja vendore.

Çdo bashki do të ketë në përbërje një grup teknik që do të bashkojë ekspertë ligjor, financiar, të burimeve njerëzore dhe IT-së të cilët do të asistojnë gjatë procesit të konsolidimit administrativ dhe financiar. Gjatë muajit janar janë zhvilluar takime në të gjithë vendin për të identifikuar ekspertët përkatës në se cilën bashki të ardhshme dhe për të formuar 61 grupet teknike të punës. Me mbështetjen e projektit "STAR" ata do të marrin trajnimin dhe njoheritë përkatëse, bazuar në metodologjinë e përpiluar, për të realizuar në kohë dhe me sukses procesin e shkrirjes së njësive vendore.



**61 GRUPE**  
pune do të trajnohen  
për procesin e  
konsolidimit  
administrativ dhe  
financiar të bashkive  
të reja

# Takime informuese



## 15 TAKIME informuese dhe konsultuese të grupit teknik në bashkitë e reja me përfaqësues të pushtetit vendor

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore,  
Bledi Çuçi gjatë vizitës në një nga  
bashkitë pilote, Pogradec

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Bledi Çuçi, në muajin dhjetor zhvilloi takime në Pogradec dhe Korçë me përfaqësues të pushtetit vendor, ku bëri të ditur hapat që do të shoqërojnë fazën e zbatimit të reformës territoriale deri në dhe pas zgjedhjeve vendore. Ministri shprehu vendozmërinë e qeverisë për të përbushur përgjegjësitë ndaj pushtetit vendor, si dhe për të përfunduar me sukses reformën territoriale.

Gjithashtu përgjatë muajve shtator-tetor 2014, grupei teknik i projektit "STAR", organizoi një raund takimesh me drejtues të drejtive të ministritë e linjës, përfaqësues të pushtetit vendor si dhe drejtues të degës së thesarit në Tiranë dhe bashkitë pilote.

Takimet e grupit teknik të projektit "STAR" u përqendruan edhe në Lezhë, Berat, Pogradec, Lushnje, Divjakë, Fier si dhe në komunat përreth, ku të zgjedhurit vendorë shprehën vullnetin e tyre për të bashkëpunuar gjatë fazës së zbatimit të reformës dhe angazhimin e plotë në procesin e konsolidimit administrativ dhe financiar. Informimi mbi hapat e mëtejshëm të reformës ishte në qendër të takimeve, ku u qartësuan çështje që lidhen me planifikimin e buxheteve, saktësimin e aseteve dhe regjistrimin e pasurive dhe detyrimet që bartin NJQV-të.

Një raund tjeter takimesh me rëndësi ishin ato me drejtues të degës së thesarit për të diskutuar përpikat kryesore që duhet të jenë në vëmendje gjatë procesit të bashkimit të njësive vendore, sa i përket dokumentacionit financiar, kontratave të shërbimeve, detyimeve të se cilës NJQV, inventarizimit të aseteve që kanë në juridikcion dhe përdorimi i të ardhurave vendore.



## PARTNERË



SWEDEN



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Embassy of Switzerland in Albania



Empowered lives.  
Resilient nations.



[www.reformatterritoriale.al](http://www.reformatterritoriale.al)



[facebook.com/reformatterritoriale](https://facebook.com/reformatterritoriale)



[youtube.com/reformatterritoriale](https://youtube.com/reformatterritoriale)